

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Islam Thaçi, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Rafete Sylja, në çështjen penale kundër të akuzuarit M.H. nga fshati ..., K. ..., për shkak të veprave penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 paragrafi 1 të KPRK-ës dhe pengimi i personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 409 paragrafi 1 të KPRK-ës, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan me numër PP.II.nr.1832/2014, të datës 03.10.2014, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me datë 16.11.2017, mori dhe shpalli publikisht me datën 22.11.2017 këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari M.I., nga babai H. dhe nëna H., e lindur J., i lindur me datë data e lindjes..., në fshatin ..., K. ..., ku edhe jeton, i martuar, baba i tre fëmijëve, pensionist, i papunësuar, ka të kryer shkollën fillore, shqiptar, shetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

I.

Sepse me datë 25.08.2014, në kohë t pavërtetuar, në fshatin ..., K. ..., ka ndezur hamulloren-arën e cila është në kufinj me fabrikën e stiropolit “ ... ”, me pompën e bezninës “ ... ” dhe dy shtëpi, me çrast ka bërë shkaktim të rrezikut të përgjithshëm.

Me këtë ka kryer veprën penale, shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 paragrafi 1 të KPRK-ës.

II.

Me datë, vend si në dispozitivin I të këtij aktgjykimi i pandehuri ka penguar personat zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare në atë mënyrë që pasi ka ndezur zjarrin në hamullore-arë, zjarrëfikësit kishin shkuar për ta fikur zjarrin mirëpo i njejt i kishte penguar dhe nuk i kishte lejuar ta bëjnë një gjë të tillë, me prast zjarrëfikësit kishin qenë të detyruar ta lajmërojnë policinë.

Me këtë ka kryer veprën penale, pengimi i personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 409 paragrafi 1 të KPRK-ës.

Andaj, gjyqtari i vetëm gjykues në bazë të nenit 4,41,42,49,50,51,46,62,69,73 dhe 74 të KPRK-ës dhe neneve 248 dhe 365 të KPRK-ës, të akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Ashtu që të akuzuarit M.I. për veprën penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 paragrafi 1 të KPRK-ës, i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 60 (gjashtëdhjetë) ditëve,

për veprën penale pengimi i personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 409 paragrafi 1 të KPRK-ës , i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 120 (njëqindnjëzetë) ditëve.

Për dy veprat në bashkim nga dispozitivi I dhe II i aktgjykimit i shqipëton , dënim me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqindetëdhjetë) ditëve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në periudhën kohore prej 2 (dy) viteve nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

Detyrohet i akuzuari që të paguajë paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € (njëzet euro) në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A R S Y E T I M

1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjiilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 07.10.2014, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr. 1832/2014, kundër të akuzuarit M.H. nga fshati ..., K. ..., për shkak të veprave penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 paragrafi 1 të KPRK-ës dhe pengimi i personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 409 paragrafi 1 të KPRK-ës.

Kjo gjykatë me datë 22.06.2017 ka mbajtur seancëm e shqyrtimit fillestar në të cilën ishin prezent prokurorja e shtetit dhe i pandehuri M.H., në të cilën seancë i pandehuri pas leximit të aktaktakuzës nga ana e prokurorit ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 paragrafi 1 të KPRK-ës, me ç'rast gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 248 paragrafi 1 të KPRK-ës ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë nga ana e të pandehurit për veprën penale nga dispozitivi I i këtij aktgjykimi, ndërsa meqenëse i pandehuri nuk e kishte pranuar fajësinë për veprën penale pengimi i personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 409 paragrafi 1 të KPRK-ës, gjyqtari i vetëm gjykues duke u bazuar në nenin 245 paragrafi 6 nëparagrafi 6.1,6.2 dhe 6.3 të KPP-ës e ka njoftuar të pandehurin se deri para senacës së shqyrtimit të dytë mund të paraqesë kërkesën për hudhjen e aktakuzës dhe kundërshtimin e provave.

Meqenëse i akuzuari nuk kishte paraqitur kërkesën për hudhjen e aktakuzës dhe kundërshtimin e provave brenda afatit të përcaktuar nga ana e gjyqtarit, gjyqtari i vetëm gjykues me datë 16.11.2017 ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor në të cilin ishin prezent prokurorja e shtetit dhe i akuzuari, në të cilën seancë i akuzuari pas leximit të aktaktakuzës nga ana e prokurores, ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale pengimi i personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 409 paragrafi 1 të KPRK-ës, me ç'rast gjykata pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë nga ana e të akuzuarit për veprën penale nga dispozitivi II i këtij aktgjykimi.

2.Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Gjyqtari i vetëm gjykues pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe shqyrtimit gjyqësor në të cilin kanë qenë prezent prokurori i shtetit dhe i akuzuari M.H., ku pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të akuzuarit për veprat penale për të cilat akuzohet ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë në kuptim të nenit 248 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të KPP-ës dhe nenit 326 të KPP-ës.

Në këtë aspekt gjyqtari ka konstatuar se i akuzuari e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se i akuzuari nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmbën ndonjë shkelje ligjore e as gabime faktike.

3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues vërtetoi këtë gjendje faktike: se i akuzuari M.H., ka kryer veprat penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 paragrafi 1 të KPRK-ës dhe pengimi i personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 409 paragrafi 1 të KPRK-ës, në kohën vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4.Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjyqtari i vetëm gjykues, me rastin e shqiptimit të dënimit duke u bazuar në nenit 248 dhe 326 të KPP-ës, ka vlerësuar se duhet të pranohet pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit M.I. dhe të njejtit për veprën penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 paragrafi 1 të KPRK-ës, i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 60 (gjashtëdhjetë) ditëve, ndërsa për veprën penale pengimi i personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 409 paragrafi 1 të KPRK-ës, i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 120 (njëqindnjëzetë) ditëve.

Për dy veprat në bashkim nga dispozitivi I dhe II i aktgjykimit i shqipëton, dënim me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqindetëdhjetë) ditëve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në periudhën kohore prej 2 (dy) viteve, nga dita e plotëfuqishmëris, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale,ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat ky dënim do të jetë i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale.

Gjyqtari me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 73,74,75 dhe 76 të KPRK-së ashtu që rrethanë posaçërisht lehtësuese ka marrë faktin se i pandehuri ka pranuar fajësinë për veprat penale për të cilën akuzohet, se i njejtë është penduar dhe ka premtuar që në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale si dhe moshën e tij ndërsa rrethana rënduese gjykata nuk gjeti ndonjë.

5.Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegësisë penale të pandehurit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Sipas bindjes së gjyqtarit të vetëm gjykues dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit M.H. duke i marrë parasysh rrethanat lartpërmendura është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, me mënyrën e kryerjes së veprës penale si dhe shkallën e përgjegësisë të pandehurit.

Gjyqtari po ashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 41 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

6.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të akuzuarit gjyqtari i vetëm gjykues duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-ës, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë ti paguajë shpenzimet procedurale sipas përlogaritjes përfundimtare nga ana e gjykatës si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € (njëzet euro), në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i përgjithshëm

P.nr.852/16, më 22. 11. 2017

Sekretarja Juridike

Rafete Syla

Gjyqtari

Islam Thaçi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njejtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj gjykate.